[33] *Albania has no agreement with its maritimeneighbors countries on Maritime SAR. On May 19, 2000 Ministry of Transportation, which was responsible in Albania for Maritime SAR prior approval of Coast Guard Law, signed an agreement with Ministry of Transportation of Italy for cooperation in Maritime SAR. The agreement was ratified by Italian Parliament and entered into force on December 2001. Albania still hasn't ratified the agreement. (noted by authors).*

[34] ***File, Çapajev Dr.*** *Kontrolli i hapësirës detare të Shqipërisë dhe ushtrimi i sovranitetit të Shtetit Shqiptar. Shtëpia Botuese e Ushtrisë. Tirana. 2009 P. 34.*

[35] ***Idem.*** *P. 100. Population of Albania, Macedonia, Kosovo and Serbia is about 16 million inhabitants. According to the calculation of Dr. File, accounting only half of population mention above, multiplying with 2 tons for every inhabitant, result that the average expected flow of goods through Albania will be 16 million tons. Ports in Puglia Region in Italy can process up to 28 million tons per year, while ports in Bulgaria can process up to 20 million tons.*

through Albania. TAP[36,37,38] is going to transit through Albania 10-20 million m^3 per year[39], while a branch is going to be used through Albania for regional needs. When and if Shëngjin Europort will be built, it will have a processing capacity more than 40 million tons per year[40]. Plans expect Albania to increase the maritime processing trade around twenty times in next ten years, by showing to turn into a maritime regional power.

The easy flow of the expecting regional trade and broader requires a new balance on funding roads, rails and port infrastructures networking. Despite Shëngjin Europort project, Albania needs to be focused on building port processing capacities mainly in Bay of Vlora, as an unlimited capacity and all year weather bay, rather than Durres Port[41], which has limited enlargement opportunities. Expected trade figures need national politics harmonization in regional terms. "*Transportation infrastructure throughout most of Southeastern Europe, including Albania, has been under-funded, neglected, and not harmonized with European Union standards*[42]*"*.

5. Respecting the fundamental freedom of the Law of the Sea

Promotion and support of the maritime activities is closely connected to the respecting of the fundamental freedoms of the Law of the Sea. The new expecting dimension of national maritime affairs will require guarantying the respect of two maritime freedoms: navigation and economic freedom.

Freedom of navigation is one of the most important fundamental freedoms of the international law of the sea and the backbone for developing maritime activity. In the same time, it is one of the national sovereignty challenges on the actual EU integration phase of Albania. Controlling and managing the maritime borders, can't limit the freedom of navigation. Freedom of navigation is vital also for the maritime and coastal tourism. Temporary and local sea denial[43], is a theory, which denials your adversaries using the sea. It can't be apply for harming your own forces or activities. Moratorium of speed boats was a mistake, which didn't improve the maritime border control and "*was not certainly the right way to address permanently those threats"* [44]. Moratorium of speed boats was in force

---

[36] ***TAP – T**rans **A**driatic **P**ipeline.* *TAP is a proposed pipeline project to transport natural gas from the Caspian and Middle East regions via a new gas transportation route starting in Greece via Albania and the Adriatic Sea to Italy and further to Western Europe. (noted by author).*

[37] ***Goga, Anastas and Metalla, Osman.*** *Implementimi i sistemeve te reja te akostimit dhe shkarkimit te anijeve te gazit te lëngshëm dhe hidrokarbureve ne det. Symposium: Albanian Maritime System and EU experience University "Ismail Qemali, Vlore. 14-15. Aulona Press. May 2010. P 139-140.*

[38] *From geo-political and geo-economic point of view, these complex infrastructure networks "are of strategic importance for Italy" -* ***Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Italy***
http://www.esteri.it/MAE/EN/Politica_Estera/Aree_Geografiche/Europa/Le_reti_infrastrutturali.htm

[39] ***TAP.*** http://www.trans-adriatic-pipeline.com/al/projekti-tap/koncepti/.

[40] ***Albanian Construction Portal.*** *http://acp.al/Projekti-Europorti-i-Shengjinit-ne-proces-finalizimi.*

[41] ***Durres Port Authority*** *– "The Port of Durres is the principle port in Albania, handling roughly 90 per cent of the country's international maritime trade tonnage and 85 % of all the export and import trade of the country. The actual level of traffic is about 3,8 million tons per year".*

[42] ***US Commercial Service*** *- http://www.trade.gov/.*

[43] ***Sea Denial -*** *Sea denial is a subset of sea control. Sea denial is achieved when maritime forces prevent an opposing force from using the sea for its own purposes. Sea denial is normally exercised in a given area and for a limited time –* ***GlobalSecurity.org***

[44] ***Gerveni, Rear Admiral Kristaq.*** *The state action at sea – Albanian perspective. Symposium: Albanian Maritime System and EU experience University "Ismail Qemali, Vlore. 14-15. Aulona Press. May 2010. P. 85.*



MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

RAPORTI PËR GJËNDJEN E MJEDISIT

Tiranë, 2014

Botim i Ministrisë së Mjedisit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Përgatitja e këtij raporti u realizua
nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Agjencia Kombëtare
e Mjedisit

Përgatitën raportin:

Alban PRIFTI
Shpati BRAHO
Loreta SULOVARI
File PREKA
Sofie ÇELIKU
Hektor XHOMARA
Kostandin DANO
Gjystina FUSHA

Shtypur në: botime Albas

Bujqësia. Eshtë një nga sektorët kryesore të ekonomisë së vendit duke kontribuar me 21% të PBB-së. Familjet rurale vazhdojnë të mbizotërojnë me mbi 50% të popullsisë dhe bujqësia përbën një altërnativë të qëndrueshme të zënies me punë të njerëzve në këto zona. Rritja mesatare reale në këto vitet e fundit në bujqësi rezulton të jetë në nivelet e 3-3.5% në vit, duke u vlerësuar si akoma larg potencialeve reale që bujqësia në vendin tonë ofron. Bujqësia është e sunduar nga ferma me sipërfaqe të vogla (mesatarisht 1.13 ha), këto të copëtuara në parcela të vogla. Ky parcelizim sjell vështirësi në prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe vështirësi në përdorimin e mekanikës bujqësore gjithashtu. Të ardhurat e siguruara nga Produktet bujqësore janë veçanërisht të orientuara drejt plotësimit të nevojave të familjeve të fermerëve. 69% e produkte bujqësore importohen nga Bashkimi Evropian.. Ndër këto produkte mund të përmendim: bimë, fidana, perime, drithëra, fruta, lëngje dhe ekstraktë etj. Numri i fermave (me madhësi nga 1-2 ha) sipas mynyrës së plugimit për 2013 ishtë: 544840. Këto lloje plugimi përfshinin punimin me dorë, me kafshë dhe me traktor.

Transporti Rrugor. Transporti rrugor është forma kryesore e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve në Shqipëri. Rrjeti rrugor në Shqipëri me të gjitha llojet e rrugëve, ku mund të lëvizin automjetet, është rreth 18.000 km i gjatë ku 3.636 km janë Rrugë Nacionale. Shqipëria ka një park automjetësh prej më shumë se 350 000 mjetësh, shumica dërmuese e të cilëve të përdorura. Rritja mesatare vjetore është relativisht e lartë 11.3 %. Pamjaftueshmëria e infrastrukturës konsiderohet sot si një ndër shkaqet kryesorë për nivelin e lartë të ndotjes në zonat urbane. Shembull tipik për këtë është Tirana ku përqëndrimi i ndërtimeve dhe zhvillimi i infrastrukturës brenda unazës së vogël ka shkaktuar në disa pika nivele deri 10 herë më të larta se norma (PM10- 432 mg/m3 kundrejt 45 që është norma). Opinioni i përhapur se kjo vjen prej numrit të lartë të mjeteve, apo vjetërsisë së tyre nuk është i bazuar sepse indeksi i motorizimit është shumë i ulët (9 mjetë për 100 banorë kundrejt mesatares europianë 60/100).

Transporti Detar. Shqipëria është e vendosur në një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm, në pjesën jug-lindore të Ballkanit, ku 1/3 e kufirit e ka det, me një vijë bregdetare prej rreth 440 km, dhe me kushte të favorshme natyrore. Në Shqipëri transporti detar mbështetet tek portet detare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm për zhvillimin e transportit por njëkohësisht edhe për zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare dhe ekonominë e vendit. Portet kryesore të vendit janë:

- ***Porti Detar i Durrësit****,* rreth 38 km larg Tiranës.Ai është porti më i madh i vendit, dhe ndër më të mëdhenjtë në detin Adriatik dhe Jon si dhe një nyje shumë e rëndësishme për për tregun ndërkombëtar. Porti i Durrësit është pozicionuar në pjesën jug-Perëndimore të qytetit të Durrësit. Infrastruktura operacionale përbëhet nga 11 kalata me një thellësi kalate qëvarion nga 7.5 m – 11.5 m. Porti i Durrësit ka aktualisht 78% të tregtisë detare në nivel kombëtar.Gjatë shtatorit të 2013 BERZH financoi me 10 milion euro një projekt për thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të portit në mynyrë që në port të mundësohet hyrja e anijeve më të mëdha.
- ***Porti Detar i Vlorës****,* i dyti port i madh në Shqipëri, i vendosur rreth 90 km në jug të Portit të Durrësit, i përcaktuar si porta e dytë hyrëse e Korridorit VIII. Këtu kryhet përpunimi i anijeve traget me pasagjerë dhe anijeve me mallra duke mbuluar rreth 10% të mallrave export-import. Në terminalin e trageteve të këtij porti kaluan 10% më pak pasagjerë krahasuar me të njëjtën periudhë të 2012. Masterplani i këtij porti, një bashkpunim i qeverisë Shqiptare me atë Italiane synon transformimin gradual të tij brenda një periudhe 2-3 vjeçare. Ky masterplan ishte në fazën e tenderimit ndërkombëtar gjatë gjysmës së parë të 2013.
- ***Porti Detar i Shëngjinit,*** i vendosur rreth 60 km në veri të portit të Durrësit dhe është porti i vetëm në këtë zonë, merret kryesisht me përpunimin e mallrave të ndryshme në rifuxho

si dhe karburante. Porti po zhvillohet me qëllim rritjen e aftësisë akostuese, përpunuese dhe sigurinë e lundrimit. Projekti “Europorti i Shëngjinit” i cili parashikohet të ndërtohet në bregdetin shkëmbor të Shëngjini ka një vlerë prej 2,2 miliardë eurosh, ishte në fazën e fizibilitetit të plotë gjatë 2013.

- ***Porti Detar i Sarandës,*** është një port sekondar i vendosur rreth 160 km në jug të Portit të Durrësit, ku përpunohen anijet e pasagjerëve dhe me mallra. Edhe ky port po zhvillohet në drejtim të shndërrimit të tij në një port turistik. Një projekt i bankës botërore me vlerë 4 milion dollarë nga të cilat 20% sigurohen nga qëveria shqiptare synontë ndërtimin e porteve të jahtëve të ndarë nga kalatat e shkarkimit të anijeve. Ky port parashikohej të përfundontë në shtatorin e vitit 2011, por për shkaqe të ndryshme punimet kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2012, aktualisht përpunimi i mallrave bëhet në gjirin e Limionit, përpunimi i mallrave bëhet me elektrovinç GANZ 5 T, ka një kalatë për përpunimin e trageteve me gjatësi 60 m linear dhe zhytje 3.5 ml thellësi.

Transporti Hekurudhor. Nga 18 000 km të rrjetit të përgjithshëm rrugor, rrjeti hekurudhor zë 447 km linjë kryesore dhe 230 km linjë sekondare. Ai shtrihet nga veriu me stacion kufitar Bajzën deri në jug me stacion fundor Vlorën, e deri në lindje me stacion fundor Pogradec, në kufi me Maqedoninë. Rrjeti hekurudhor shqiptar lidhet me rrjetin hekurudhor ndërkombëtar nëpërmjet linjës Bajzë - Podgoricë, Mal i Zi, ku aktualisht kryhet transporti ndërkombëtar i mallrave, por ky shërbim nuk ofrohet për pasagjerë. Ai lidhet gjithashtu me Portin e Durrësit, që është edhe porti hyrës i Korridorit të VIII-të. Trenat nuk janë elektrikë.
Tre linjat hekurudhore të Shqipërisë janë:

- Nga Tirana me drejtim veriun e Shqipërisë, duke kaluar në Vorë, Mamurras, Laç, Milot, Lezhë, Shkodër, Bajzë dhe Hani i Hotit(për pasagjerë deri në Shkodër).
- Nga Tirana me drejtim juglindjen e Shqipërisë, duke kaluar në Durrës, Golem, Kavajë, Rrogozhinë, Peqin, Elbasan, Librazhd, Përrenjas dhe Guri i Kuq. Ky i fundit ndodhet fare pranë qytetit të Pogradecit.
- Nga Tirana me drejtim jugun e Shqipërisë, duke kaluar në Durrës, Golem, Kavajë, Rrogozhinë, Lushnje, Fier dhe Vlorë.

Transporti Ajror. Zhvillimi i Transportit Ajror në Shqipëri mbështetet tek i vetmi Aeroport Ndërkombëtar “Nënë Tereza” në Rinas, i cili është i vetmi aeroport funksional në vend. Aeroporti ndodhet rreth 17 km në veri Perëndim të Tiranës. Aeroport tjetër rajonal në Kukës është funksional por jo në përdorim të plotë siç ishtë planifikuar. Përveç Aeroportit ‘Nënë Tëreza’ në Shqipëri ekzistojnë tetë pista të tjera aviacioni civil, shumica prej tyre të paasfaltuara dhe disa prej tyre të tjetërsuara në përdorim. Brenda vendit, për momentin nuk egziston një shërbim i tillë për shkak të mungesës së interesit për këtë lloj transporti, kjo si rrjedhojë e tregut të kufizuar dhe distancave relativisht të vogla.

ZHVILLIMI TURIZMIT NË SHQIPËRI

Shqipëria ka përafërsisht 450 km vijë bregdetare. Bregdeti Adriatik shquhet për plazhet ranore dhe të cekëta, këto të fundit shumë të përshtashme për pushimet e familjarëve. Bregdeti i Jonit, i quajtur ndryshe “Riviera Shqiptare”, me shtrirje nga Vlora në Sarandë, shquhet për panoramat mjaft të bukura si dhe për cilësinë e lartë të ujërave detare. Ky bregdet është shkëmbor dhe kryesisht i ashpër me male të thepisur që bien me pjerrësi në det. Ajo çka përbën të veçantën

Postuar më: 16 Janar 2014

Nënshkruhet Protokolli i Sesionit të Tetë të Komisionit të Përbashkët “Për Bashkëpunimin Ekonomik e Tregtar Shqipëri-Kinë”.



FJALA E PLOTË E MINISTRIT ARBEN AHMETAJ

I nderuar Zoti Xiaofeng,

Të nderuar anëtarë të delegacioneve kineze dhe shqiptare,

Zonja dhe Zotërinj,

Do të doja të shprehja ngrohtësisht mirëseardhjen për të ftuarit tanë kinezë në Shqipëri.

Jam i nderuar që pas takimit të Kryeministrit Kinez dhe Kryeministrit shqiptar ne Bukuresht unë sot pres këtë delegacion të Ministrisë së Tregtisë së Kinës në kuadër të Sesionit të Tetë të Komisionit të Përbashkët për Bashkëpunimin Ekonomik e Tregtar. Këto takime dhe vizita të larmishme janë një dëshmi e fuqishme e marrëdhënieve të shkëlqyera dypalëshe dhe të një dialogu intensiv dhe bashkëveprimi midis Shqipërisë dhe Kinës.

Ky Sesion për Ekonominë dhe Tregtinë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ne, sepse Kina është ekonomia e dytë më fuqishme në botë ndaj dhe nxitja e raporteve ekonomike mes vendeve merr një rëndësi të veçantë në këtë periudhë kur aktiviteti ekonomik në vendin tonë është ngadalësuar.

Vendi ynë trashëgoi një model ekonomik me mitje ekonomike pa punësim, me borxhe dhe me mbështetje në remitanca (të cilat pësuan rënie në vitet e fundit për shkak të krizës).

Qeveria e re shqiptare është angazhuar të ndërtojë një model të ri ekonomik të zhvillimit të qëndrueshëm, të shoqëruar me një disiplinë të re fiskale, me luftë ndaj informalitetit, nxitjen e prodhimit vendas dhe kthimi në faktorë mitjeje të burimeve natyrore të vendit.

Taksimi i ndershëm, mbështetja e sipërmarrjes (me fokus në në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), garantimi i konkurrencës së lirë, si edhe përgjegjshmëria në marrëdhëniet me komunitetin e biznesit janë prioritet i qeverisë së re.

U ul tatimi mbi të ardhurat personale për 97% të shqiptarëve, përmes heqjes së taksës së sheshtë dhe vendosjes së taksimit të ndershëm, u eleminua taksa e biznesit të vogël dhe u ul tatimi mbi fitimin për biznesin e vogël nga 10% në 7,5%. U eleminua tatimi mbi vlerën e shtuar për shërbimet shëndetësore dhe barnat.

Në funksion të tërheqjes së investimeve direkte ne po punojmë për krijimin e një klime të favorshme dhe tërheqëse për biznesin. Nga ana jonë janë marrë këto masa:

Njohëm borxhin që ish qeveria kishte ndaj biznesit dhe do të paguajmë në mënyrë transparente dhe të drejtë borxhet e akumuluara ndaj bizneseve gjë që do të vërë në lëvizje ekonominë dhe do të ndikojë pozitivisht në mitjen e saj.

Është ngritur “Këshilli Ekonomik Kombëtar”, nën drejtimin e Kryeministrit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të biznesit dhe konsulentëve me famë botërore, për konsultime në funksion të vendimmarrjes, si edhe për dëgjimin e drejtpërdrejtë të shqetësimeve të tyre në lidhje me procedura burokratike apo të padrejta që frenojnë aktivitetin e tyre.

Çdo sipërmarrje ka tashmë mundësi të “ankimit online” për proçedurat ligjore dhe administrative, duke aksesuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe në faqen e Këshillit Ekonomik Kombëtar që është duke u ngritur.

Ne do të angazhohemi të krijojmë një sistem rregullator që lehtëson funksionimin e tregut dhe që mbron interesat e publikut , një sistem që buron dhe administrohet nga institucione solide.

Ne vlerësojmë bashkëpunimin e deritanishëm me qeverinë kineze, bashkëpunim ky: financiar, ekonomik, tregtar e teknik.

I jemi mirënjohës qeverisë kineze për kontributin e saj në financimin e projekteve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe për asistencën teknike të ofruar për ngritjen e kapaciteteve, për stafet teknike dhe funksionarët e administratës shqiptare.

Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare mes vendeve tona vitet e fundit kanë pësuar rritje por shkalla e tregtisë dhe e bashkëpunimit ekonomik mbetet nën mundësitë reale. Duam që shkëmbimet tona tregtare të rriten dhe ky është momenti i duhur për të vepruar. Bashkëpunimi jonë duhet të rritet akoma më shumë me veprime konkrete.

Kina është një partner shumë i rëndësishëm tregtar për Shqipërinë. Ne do të angazhohemi që të lehtësojmë tregtinë midis kompanive kineze dhe shqiptare dhe operatorëve ekonomikë dhe për të adresuar çdo problem të mundshëm tregtar.

Edhe pse distanca gjeografike midis vendeve tona mund të konsiderohet si një disavantazh për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe vënien në jetë të projekteve konkrete, vullneti ynë politik për rritjen e bashkëpunimit është mjaft i fortë për të kapërcyer këto pengesa fizike. Për më tepër, sot mund të shfrytëzohen mjetet e ofruara nga teknologjia dhe informacioni dhe tregtia elektronike. Zhvillimi i tregtisë elektronike ndërkombëtare sigurisht do të nxitë edhe shërbimet e biznesit elektronik, çka do të bëhet edhe një pikë e re për rritjen e bashkëpunimit mes vendeve.

Sipas informacioni më të fundit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) janë rreth 83 kompani kineze të pranishme në Shqipëri-kryesisht kompani të vogla. Ne do të vlerësonim së tepërmi rritjen e prezencës së kompanive kineze për të investuar në të gjithë sektorët e ekonomisë në të ardhmen ndaj po marrim të gjitha masat për të lehtësuar hyrjen e biznesit të huaj në Shqipëri.

Themelimi në shtator 2013 i "*Dhomës së Tregtisë Kinë-Shqipëri*" besojmë se do shërbejë si një pikë takimi për aktorët e zhvillimit të vendit dhe mes investitorëve dhe qeverisë. Ajo do të shndërrohet në një urë lidhëse për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve dhe do të ndikojë në tërheqjen e më shumë investimeve kineze në Shqipëri.

Për sa kohë që të dy vendet ruajnë besimin për bashkëpunim dhe mes tyre ka një marrëdhënie miqësore historike, ne jemi te hapur për një bashkëpunim gjithëpërfshirës. Ne besojmë fuqimisht se ***energjia, transporti dhe infrastruktura*** janë fusha bashkëpunimi me një potencial të madh për të përfituar. Përpjekjet tona drejt shfrytëzimit të përdorimit më të mirë të potencialeve të vendeve tona do të japë fryt në dobi të popujve tanë.

Ne vlerësojmë rëndësinë që ka për qeverinë shqiptare "Nisma e Bashkëpunimit Kinë – vendet e Europës Qendrore e Lindore" dhe platforma e saj prej 12 pikash, lancuar në prill 2012 nga ish-Kryeministri kinez, z. Wen Jiabao.

Ne do të studiojmë të gjitha projektet e zhvillimit dhe mundësitë për financimin e tyre, në fushat tona prioritare si energjetikës, në infrastrukturë, transport, industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, bujqësi, zonat e lira, arsim dhe kulturë, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare.

Ne jemi të interesuar të njohim termat e referencës të paketës së propozimeve që lidhen me aplikimin në fondin kinez të kreditimit prej 10 miliard $ si dhe në atë të investimeve prej 500 milion $ dhe shpresojmë se projektet që do të propozohen do të konsiderohen financiarisht në terma të leverdisshëm.

Ne ftojmë investitorët kinezë për të investuar në zhvillimin e zonave ekonomike mbi bazën e partneritet të sektorit publik me atë privat duke shpresuar futjen e teknologjisë së avancuar dhe marrjen e përvojës kineze në drejtim të krijimit të zonave ekonomike dhe parqeve industriale.

Lidhur me fushën e transportit dhe infrastrukturës, një nga projektet tona prioritare është "Ndërtimi i Portit të ri të Shëngjinit"- një projekt jo vetëm për Shqipërinë, por për Kosovën, Serbinë, Bullgarinë dhe për gjithë rajonin, i cili do të ndikojë në zhvillimin e gjithë rajonit, sidomos në rritjen e shkëmbimeve tregtare.

Ne jemi të interesuar për bashkëpunim në fushën e detarisë, ndërmjet dy vendeve, bazuar në standardet ndërkombëtare e cila do të krijojë një bazë reale për rritjen e bashkëpunimit në këtë fushë.

Ne do të vlerësonin edhe bashkëpunimin në Partneritetin Publik Privat (PPP) të rrjetit hekurudhor apo bashkëpunime në fushën e pjesëve të këmbimit për "rolling stock" dhe infrastrukturën apo dhe në fushën e ujësjellës–kanalizime, ku pala shqiptare do të vlerësonte asistencën dhe bashkëpunimin e palës kineze lidhur me politikat, shërbimet dhe trajtimet në sektorin ujësjellës-kanalizime.

Sa i takon sektorit energjetik, nga pala shqiptare janë identifikuar një numër i konsiderueshëm projektesh të rëndësishme si psh.

"Për rritjen e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike- ku përfshihen Projektet: "Ndërtimi i hidrocentraleve mbi lumin Drini i Zi (Skavica) dhe "Ndërtimi i Hidrocentraleve mbi lumin Vjosa" dhe "Për rritjen e kapaciteteve transmetimit të energjisë elektrike*"* ku përfshihet projekti: "Ndërtimi i Linjës 400 kV nënujore të Interkonjeksionit Shqipëri–Itali",projekte të cilat do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, si dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike.

Një formë bashkëpunimi mund të jetë në burimet e rinovueshme të energjisë, në transferimin e njohurive dhe teknologjive dhe të sistemeve të paneleve diellore, në fushën e prodhimit dhe transformimit të energjisë diellore, duke marrë në konsideratë që Republika Popullore e Kinës është prodhuesi më i madh botëror i celulave fotovoltaike.

Bashkëpunimi në sektorin e Hidrokarbureve dhe sektorin e shfrytëzimit të burimeve minerare mund të jetë formë tjetër bashkëpunimi. Zbatimi i Projektit të Gazsjellësit TAP/IAP, do të jetë një mundësi e mirë për tërheqjen e bizneseve kompetitive kineze, në projektet e gazifikimit të Shqipërisë.

Ne shprehim interes për bashkëpunime dhe partneritete me kompani homologe kineze duke krijuar ndërmarrje të përbashkëta (joint venture). Disa sektorë të tjerë ku ky bashkëpunim do të jetë i suksesshëm dhe me përfitime të dyanshme janë psh: industria e fasonit dhe industria përpunuese e ambalazheve, ku teknologjia kineze gjen traditën e mirë që Shqipëria ka patur në këtë sektor në të kaluarën, fushat e bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit.

Një tjetër formë bashkëpunimi, janë bashkëpunimet institucionale, mes institucioneve hartuese dhe zbatuese të politikave ekonomike, mes agjensive në ndihmë të biznesit dhe investimeve, lidhur me zhvillimin e sektorit privat, të konkurrueshmërisë, mbrojtjes së konsumatorit, zonat ekonomike dhe parqet industriale, nxitjen e eksporteve, si dhe në drejtim të shkëmbimeve të informacioneve dhe të marrjes së përvojës kineze.

Uroj që ky Sesion të nxisë bashkëpunimin dypalësh në të gjitha fushat e ekonomisë. Shpresoj që edhe përfaqësuesit e biznesit të reagojnë shpejt dhe të kenë kontakte të frytshme dhe dialog më intensiv, dhe pse jo edhe firmosje kontratash të reja.

Faleminderit